



## KOMUNIKATË

3.11.2009

Komisionit Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e vetë të 51-të, fillimisht ka miratuar raportin nga mbledhja nr. 42/ 2009. KQZ, në këtë mbledhje ka miratuar edhe rekomandimet dhe udhëzuesin për stafin e të gjitha vendvotimeve në zgjedhjet e 15 nëntorit, për mënyrën e përdorimit të SMS-ve për rezultatet preliminare në zgjedhjet lokale të 15 nëntorit. Kryetarja Nesrin Lushta, ka kërkuar informacione lidhur me SMS-të nga IFES. Lidhur me këtë projekt, Kryeshefi i SKQZ-së Xhemajl Peqani, ka informuar KQZ-në me përgatitjet që po bëhen për trajnimet lidhur me SMS-në, duke kërkuar shqyrtime të mëtutjeshme, sygjerime për mënyrën më të mirë të trajnimit. “Nesër prej ores 11, fillon trajnimi i stafit zyrtar për SMS-të. Këta zyrtar, do të trajnojnë të tjerë trajner që do të trajnojnë pastaj, personat që me short do të zgjedhen në KVV. Gjithashtu, 20 mijë kopje të materialeve për trajnim do të përgatiten nga IFES”, ka thënë z. Peqani.

Betim Gjoshi, anëtar i KQZ-së ka vlerësuar se ky projekt është në interes të procesit zgjedhor. “Tani e kemi këtë projekt më të detalizuar. Kërkoj që IFES-i të përgatisë sa më shpejt që të jetë e mundur doracakët për përdorimin e SMS-ve, gjithashtu edhe kodet”, ka thënë z. Gjoshi. Xhelil Pajaziti, anëtar i KQZ-së vlerësoi se pavarësisht sfidave që mund të paraqiten në procesin e informimit ky projekt është i rëndësishëm, ngase me ligj është e përcaktuar qartë se vetëm KQZ-ja e shpall rezultatin e zgjedhjeve. “Unë e pëlqej këtë program që është bërë dhe më duket se është në rregull. Jashtë atyre çështjeve teknike, po e them mendimin tim personal se deri në fillimin e numërimit të votave në KKV këto informata do të rrjedhin shumë mirë, por kam frikë se kur të filloj numërimi i votave në KKV, nga përvoja që kam ndoshta disa anëtar nuk do ta kryejnë obligimin e vetë sikur që e marrin. Mirëpo ky le të jetë vetëm një supozim”, ka thënë z. Pajaziti.

Florian Dushi, anëtar i KQZ-së tha se me vetë faktin që KQZ ka shpërndarë edhe udhëzimin administrativ i cili sanksionon raportimin, përgjegjësia e raportimit do të jetë gjithsesi në nivelin më të lartë. “Personat që do të dërgojnë SMS, kryesuesi dhe dy anëtarë të këshillave të vendvotimeve, duhet të dërgojnë të dhëna të sakta. Në të kundërtën mbajnë përgjegjësi ligjore”, ka thënë z. Dushi. Në shqyrtimin e projektit për SMS, janë angazhuar edhe anëtarët e tjerë të KQZ-së, sidomos rreth nevojës dhe rëndësisë që ka ky projekt për të dhënë një rezultat preliminar për zgjedhjet sepse, KQZ duhet ta ketë rezultatin e vetë të votimeve.

Chedomir Flego, Drejtor i IFES-it e ka informuar KQZ-në me përgatitjet që janë bërë. Tashmë dihet që është përgatitur Serveri, rrjeti i sistemit telefonik do të funksionoj përmes VALE-s dhe IPKO-s. Anëtarët e KQZ-së, janë interesuar sidomos nëse ky sistem

mund t'i ketë vështirësitë e veta, gabimet etj. Flego, ka shpejguar që ka qenë dizajner në këso projekte dhe ka punuar me specialist në projektet me SMS. "Pjesë e sistemit është metabaza që grumbullon të gjitha të dhënat. Ne, do t'i identifikojmë të gjithë kandidatët. Personat që do të dërgojnë SMS, do t'i kenë kodet. Jemi duke e testuar projektin dhe këtë do ta bëjm edhe me trajnerët që do t'i trajnojmë. IFES do të shoh nëse ka ndonjë gabim, ose nëse mund të vij deri te ndonjë gabim. Është e mundur që dikush të provoj të dërgoj të dhëna të rreme por sistemi i dizajnuar është i mbrojtur dhe nuk pranon të dhëna të rreme. Ai na tregon ne se dikush ka provuar të na dërgoj ne të dhëna të rreme. Sistemi regjistron këto përpjekje telefonike për të dërguar të dhëna të rreme dhe ne mund ti hetojmë ato", ka shpjeguar z. Flego. Anëtarët e KQZ-së, kanë shqyrtuar deri në detale projektin me SMS dhe, kanë aprovuar një Udhëzim të përgatitur që do t'u dërgohet personave të autorizuar që do të dërgojnë SMS-të (kryesuesi dhe dy anëtarë të KVV-e ), në mënyrë që ata të dërgojnë të dhëna të sakta. Në të kundërtën, do të mbajnë përgjegjësi ligjore sipas dispozitave të nenit 74. 10 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Zgjedhjet Lokale, sipas Kodit të Sjeljes së anëtarëve të KVV-e dhe, Kodit Penal të Kosovës.

Në vazhdim të mbledhjes, KQZ është informuar nga Zyra për Regjistrimin e Partive Politike lidhur me rekomandimet e Këshillit të Procedurave për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me zgjidhjen e kontesteve të krijuara brenda Partisë Politike Srpska Demokratska Stranka Kosova i Metohija - SDSKIM. ZRPP, ka rekomanduar që lista e kandidatëve të SDSKIM-së, e cila është certifikuar brenda afatit ligjor për certifikim nuk mund të ndryshohet. Të njihet për legjitim kryetari dhe kryesia e deritanishme deri në përfundim të zgjedhjeve lokale. Personat kontaktues për zyren, janë ata që sipas Statutit i emëron kryetari i Partisë; Rekomandohet të mos njihet Kuvendi i Jashtëzakonshëm, i cili është mbajtur në kundërshtim me Statutin e Partisë Politike të SDSKIM-së; Palët në procedurë statutare i zgjidhin kontestet brenda strukturave të Partisë, me thirrjen e një Kuvendi, i cili duhet të mbahet sipas procedurave të përcaktuara me Statut, dhe duhet ta dëshmojnë bindshëm validitetin e të gjitha vendimeve të marrura nëpërmes dokumentacionit që i dorëzohet Zyres. KQZ aprovoi rekomandimin e Këshillit për Procedura.

KQZ në mbledhjen e sotshme ka miratuar edhe propozimin për pagesat e stafit teknik në qendren e numërimit të rezultateve QNR. Me një vendim të posaçëm KQZ-ja dje ka bërë të njohur dhe shkallën e pagesës së stafit teknik i cili do të jetë i angazhuar për 28 ditë pune në Qendrën e Numërimit të Rezultateve. Pagesa është planifikuar dhe miratuar të jetë në neto, 22 euro në ditë pune për mbikëqyrësit e hapësirës së futjes së të dhënave dhe për zëvendësit e tyre. Nga 18 euro për ditë pune do të paguhet mbikëqyrësit e auditivit dhe disa kategori të tjera përcjellëse. Niveli më i ulët i pagesës ditore do të jetë për 15 euro në ditë pune dhe përfshin nëpunësit e evidentimit, futjes së të dhënave në pranim, numëruesit, nëpunësit e pranimit dhe kategori të tjera të këtij niveli. Gjithsejtë do të jenë 484 anëtar të stafit teknik të cilët do të jenë të angazhuar në Qendrën e numërimit të rezultateve për zgjedhjet lokale të 15 nëntorit.